



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.251/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj, kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesë e Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), paraqitur kundër Subjektit Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 01.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.251/2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), paraqitur kundër Subjektit Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datën 29.01.2025 PZAP-i, ka pranuar Ankesën Anr.251/2025, nga Subjekti Politik Partia Liberale Egjiptiane-PLE, me seli në Pejë kundër subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës-IRDK me seli në Pejë, me të cilën pretendohet se Elbert Krasniqi, Kryetar i partisë Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës-IRDK, më datën 28.01.2025 ka publikuar në profilin e tij në facebook fotografi nga tubimi parazgjedhor në Mitrovicë, ku shihen fëmijët e moshës 15 vjeçare. Më tutje theksohet se në këtë mënyrë Elbert Krasniqi në cilësi të kryetarit të IRDK-së, në këtë fotografi ka keqpërdorur fëmijët e mitur për qëllime politike dhe gjatë fushatës zgjedhore, sidomos ata të moshës nën 16 vjeçare, duke e ditur se fëmijët janë kategori e ndjeshme e shoqërisë dhe ekspozimi i tyre për qëllime politike është i kundërligjshëm dhe bie ndesh me nenin 45, par.3 të LIGJIT NR. 06/1-084 PËR MBROJTJEN E FËMIJËS, që ka të bëjë me mbrojtjen e fëmijëve në masmedia, ashtu që me këtë nen është e përcaktuar se "Mjetet e komunikimit masiv, përfshirë mediet e shkruara dhe elektronike, botimet, televizionin, radion, reklamat, kinemanë, internetin dhe mediet

online, portalet, janë të obliguara që të kontribuojnë në mënyrë aktive për të afirmuar mbrojtjen e fëmijës me realizimin e veprimtarive vetëdijesuese dhe duke këshilluar publikun mbi ndikimet e mundshme negative që ekspozimi ndaj medieve mund të ketë mbi fëmijën. Në ankesë theksojnë se pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të bëhet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve". PLE theksojnë se kjo shihet edhe në fotografinë Elbert Krasniqi, që bërë fushatë me këto pamje të prezantuara ku është e përshkruar Voto 111 ku ky numër është i partisë IRDK me të cilën garon në zgjedhjet e 09 Shkurt 2025 për Kuvend të Kosovës si dhe ka shkruar: "Në Mitrovicë si në çdo vend tjetër, fryma e fitorës po ndjehet dhe emri i fituesit tashmë po dihet. Këto zgjedhje fituese është IRDK dhe mbështetësit e kësaj familje

Parashtruesi i ankesës si prova ka bashkangjitur fotot të postuara në facebook nga tubimi në fjalë të datës 28.01.2025.

Më datë 29.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës-IRDK, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më datë 30.01.2025.

Në Përgjigjen në ankesën Anr.251/2025 subjekti politik IRDK ka theksuar se e kundërshton në tërësi ankesën për faktin se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruesit të ankesës, pasi që personi që pala ankuese pretendon se është i mitur nuk qëndrojnë i njëjti është personi A.H i moshës 17 vjeçare. Lidhur me këtë si dëshmi ka bashkangjitur kopjen e letërnjoftimit të njëjtit.

PZAP, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë të paraqitur nga subjekti Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës-IRDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane-PLE, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar neni 5 paragrafi 3 parasheh se "*Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhoje persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatën zgjedhore. Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të bëhet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve.*", me arsyetimin se bazuar në përgjigjen në ankesën Anr.251/2025 rezulton se personi në fjalë është 17 vjeçar, fakt ky që e argumentojnë edhe provat e bashkangjitura si *Letërnjoftimi personal i A.H i cili shihet se ka lindur në vitin 2008 që rezulton se nuk është fëmijë nën moshën 15 vjet. Paneli vlerësoi se në rastin konkret personi në fjalë është 17 vjeçar dhe bazuar në dispozitën e nenit 5 par.4 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 personave të moshës prej 16 deri në 18 vjet ju lejohet përfshirja në aktivitetet e fushatës, vetëm me vullnetin e tyre dhe pas orarit të mësimt.*


Parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë, ka vërtetuar se në këtë rast nuk kemi shkelje të rregullave zgjedhore dhe shkelje të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.251/2025 datë 29.01.2025

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.